VENDIM
Nr. 502, datë 6.7.2016

PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MYNIH, NË REPUBLIKËN FEDERALE TË GJERMANISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Mynih, në Republikën Federale të Gjermanisë.
2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi